FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 169

Tiranë – E hënë, 20 nëntor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 15.11.2023	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për Bashkinë Pogradec, për financimin e tarifës së pjesëmarrjes për organizimin e aktivitetit ndërkombëtar "Kampionati Botëror i Formula 1 H_2o".....	20841
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 13.11.2023	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar.....	20841
Udhëzim i ministrit të Kulturës nr. 694, datë 3.11.2023	Për procedurat e përditësimin të bazës së të dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura.....	20854
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 156, datë 15.11.2023	Për përcaktimin e drejtorisë që duhet të përmbushë rolin e autoritetit menaxhues e të drejtuesit të autoritetit menaxhues, si dhe delegimi i të drejtave të nënshkrimit.....	20863
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 642, datë 13.11.2023	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, gjimnazi "Universi" Ballsh.....	20864
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 12.10.2023	Federata Shqiptare e Mundjes dhe Viron Bezhani kundër Shqipërisë (*kërkesa nr. 11485/11)*.....	20865
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Petrit Çela.....	20867

VENDIM
Nr. 638, datë 15.11.2023

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2023, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR BASHKINË POGRADEC, PËR FINANCIMIN E TARIFËS SË PJESËMARRJES PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETIT NDËRKOMBËTAR "KAMPIONATI BOTËROR I FORMULA 1 H_2O"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi prej 106 000 000 (njëqind e gjashtë milionë) lekësh në programin "Zhvillimi i sportit dhe rinisë", për Bashkinë Pogradec, për financimin e vlerës së tarifës së pjesëmarrjes "*Staging fee*" për realizimin e aktivitetit ndërkombëtar "Kampionati Botëror i Formula 1 H_2O".

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i transferohet njësisë së vetëqeverisjes vendore, Bashkia Pogradec, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në formë transferte, llogaria ekonomike 604.

3. Bashkia Pogradec kryen pagesën e tarifës së pjesëmarrjes për realizimin e aktivitetit ndërkombëtar "Kampionati Botëror i Formula 1 H_2O", sipas akteve të saj të angazhimit, pasi të ketë administruar dokumentacionin e nevojshëm që garanton zhvillimin e aktivitetit dhe financimin e plotë të tij nga organizatorët.

4. Efektet financiare, në shumën prej 106 000 000 (njëqind e gjashtë milionë) lekësh, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit, i miratuar për vitin 2023.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 22, datë 13.11.2023

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR EMËRIMIN, ULJEN NË DETYRË, PEZULLIMIN DHE SHKARKIMIN E DREJTORIT DHE NËNDREJTORIT TË INSTITUCIONIT PUBLIK ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 10 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
PROCEDURAT PËR EMËRIMIN E DREJTORIT DHE NËNDREJTORIT TË INSTITUCIONIT PUBLIK ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Neni 1
Shpallja e vendit të lirë

1. Për shpalljen e vendit të lirë për drejtor në institucionet publike të arsimit parauniversitar (IPAP), ndiqet procedura si më poshtë:

a) Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP), menjëherë nga krijimi i vendit të lirë për drejtor të IPAP-së që ka në juridiksion, njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) për vendin e lirë të punës dhe vë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).

b) DRAP shpall vendin e lirë të punës për drejtor menjëherë nga njoftimi i ZVAP-së.

c) Vendi i lirë për drejtor të IPAP-së shpallet në faqen zyrtare të DRAP-së dhe të ZVAP-së, në këndin e njoftimeve të ZVAP-së dhe të IPAP-së, për të cilin bëhet shpallja e vendit të lirë për drejtor.

2. Për shpalljen e vendit të lirë për nëndrejtor në institucionet publike të arsimit parauniversitar (IPAP), ndiqet procedura si më poshtë:

a) Drejtori i IPAP-së, menjëherë nga krijimi i vendit të lirë për nëndrejtor, njofton zyrtarisht ZVAP-në për vendin e lirë të punës.

b) ZVAP-ja shpall vendin e lirë të punës për nëndrejtor menjëherë nga njoftimi i drejtorit të IPAP-së.

c) Vendi i lirë për nëndrejtor të IPAP-së shpallet në faqen zyrtare të ZVAP-së, në këndin e njoftimeve të ZVAP-së dhe në këndin e njoftimeve të IPAP-së, për të cilin bëhet shpallja e vendit të lirë për nëndrejtor.

3. Shpallja e vendit të lirë të punës për drejtor apo nëndrejtor duhet të përmbajë:

a) kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor apo nëndrejtor të IPAP-së;

b) dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit të tij;

c) datën e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit;

d) afatin e plotësimit të dokumentacionit pas verifikimit paraprak të tij;

e) fushat e njohurive dhe aftësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar;

f) datën e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyrën e komunikimit të tyre;

g) të drejtën dhe afatet e ankimit për çdo fazë të konkurrimit.

Neni 2
Kushtet që duhet të plotësojë kandidati

Kandidati për drejtor apo nëndrejtor i IPAP-së duhet të plotësojë kushtet si vijon:

a) të zotërojë arsimim si mësues, sipas përcaktimeve në nenin 57, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar", me vlerësim jo më pak se "Mirë" në kualifikimin e fundit;

c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij;

d) të jetë i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar, ose të jetë pranuar për ta kryer atë.

Neni 3
Dokumentacioni i aplikimit, afati dhe mënyra e dorëzimit të tij

1. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit apo nëndrejtorit në IPAP përmban:

a) jetëshkrimin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

b) kopjen e librezës së punës;

c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);

d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

e) certifikatën e drejtuesit të IPAP-së ose vërtetimin nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor, në rast se e disponon;

f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

h) deklaratën për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 8, të këtij udhëzimi;

i) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP-së (bashkëshort / bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike në ZVAP për kandidatin për drejtor dhe në IPAP për kandidatin për nëndrejtor. Dorëzimi i dokumentacionit kryhet jo më vonë se dhjetë ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për drejtor apo nëndrejtor të IPAP-së, në faqen elektronike zyrtare të DRAP-së, për drejtorin apo ZVAP-së për nëndrejtorin.

Neni 4

Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP

1. Komisioni ngrihet nga ZVAP-ja, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar dhe përbëhet nga anëtarët si vijon:

a) një përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore ku ndodhet IPAP-ja;

b) një përfaqësues i ZVAP-së që ka në juridiksion IPAP-në;

c) kryetari i bordit të IPAP-së;

d) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP-së;

e) dy mësues të IPAP-së, të zgjedhur nga këshilli i mësuesve të tij.

2. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga titullari i ZVAP-së nga njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë institucion arsimor.

3. Këshilli i mësuesve të IPAP-së zgjedh si anëtarë të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash.

4. Anëtarët e Komisionit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin, në kuptim të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit. Në mbledhjen e parë të Komisionit, anëtarët plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote.

6. Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së, jo më vonë se tri ditë pune pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për drejtor të IPAP-së dhe kur është e pranishme shumica e anëtarëve të tij.

7. Komisioni kryen këto detyra:

a) bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimit, brenda dy ditëve pune, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) njofton me shkrim/*e-mail* aplikantët për mangësitë e konstatuara në dokumentacion. Aplikanti bën plotësimin e dokumentacionit brenda tri ditëve pune nga data e njoftimit;

c) pas përfundimit të afatit të përcaktuar në shkronjën "b" të kësaj pike, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni;

d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP-së, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit. Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune;

f) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;

g) brenda tri ditëve pune, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

8. Kandidatët kanë në drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda tri ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune.

9. Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, dosjet e aplikimit dhe vlerësimet me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e institucionit, në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

Neni 5

Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit të IPAP-së

1. Komisioni i shqyrtimit dhe i vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit të IPAP-së, në vijim "Komisioni", ngrihet nga drejtori i IPAP-së, në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar dhe përbëhet nga anëtarët si vijon:

a) kryetari i bordit të IPAP-së;

b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP-së;

c) dy mësues të IPAP-së;

d) një përfaqësues i ZVAP-së.

2. Njëri prej 2 (dy) mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë IPAP, drejton Komisionin e Vlerësimit.

3. Përfaqësuesi i ZVAP-së caktohet nga drejtori i institucionit vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar që ka në juridiksion IPAP-në për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit.

4. Këshilli i mësuesve të IPAP-së zgjedh si anëtarë të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash.

5. Anëtarët e Komisionit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin, në kuptim të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit. Në mbledhjen e parë të Komisionit, anëtarët plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Drejtori i IPAP-së njofton zyrtarisht anëtarët e Komisionit për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së tij.

7. Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote.

8. Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së, jo më vonë se tri ditë pune pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për nëndrejtor të IPAP-së dhe kur është e pranishme shumica e anëtarëve të tij.

9. Komisioni kryen këto detyra:

a) bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimit, brenda 2 (dy) ditëve pune nga mbledhja e Komisionit, sipas shtojcave 1 dhe 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) njofton me shkrim/*e-mail* aplikantët për mangësitë e konstatuara në dokumentacion. Aplikanti bën plotësimin e dokumentacionit brenda tri ditëve pune nga data e njoftimit;

c) pas përfundimit të afatit, sipas shkronjës "b" të kësaj pike, liston aplikantët të cilët kanë dokumentacionin e plotë dhe të saktë dhe vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për nëndrejtor të IPAP-së, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi, brenda dy ditëve pune nga listimi i aplikantëve;

d) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit. Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune;

e) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;

f) brenda tri ditëve pune, pas përfundimit të intervistave, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

10. Kandidatët kanë në drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda tri ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune.

11. Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të IPAP-së dosjet e aplikimit dhe vlerësimet me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e institucionit në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

Neni 6

Procedura e emërimit të drejtorit të IPAP-së nga drejtori i DRAP-së

1. Sektori i Shërbimeve në ZVAP ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP-së, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi/ mungesë në dokumentacionin e dorëzuar.

2. Drejtori i ZVAP-së, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.

3. Titullari i DRAP, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP-ja, interviston dy kandidatët.

4. Intervistat dokumentohen nga sekretari i drejtorit të DRAP-së dhe arkivohen në DRAP në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

5. Brenda tri ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët, titullari i institucionit rajonal përgjegjës për arsimin parauniversitar shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP-së.

6. Kandidati jofitues ka të drejtë të paraqesë ankesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), brenda tri ditëve pune nga shpallja e kandidatit fitues.

7. MAS-i shqyrton ankesën dhe jep përgjigjen brenda dhjetë ditëve pune, pas përfundimit të afatit të ankimit.

8. Titullari i DRAP bën emërimin e drejtorit të IPAP-së. Vendimi i emërimit i komunikohet

zyrtarisht ZVAP-së. ZVAP-ja i dërgon vendimin e emërimit drejtorit të sapoemëruar dhe drejtorit që drejton përkohësisht IPAP, sipas pikës 2, të nenit 8, të këtij kreu.

9. Drejtori i IPAP-së nuk duhet të bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike.

Neni 7
Procedura e emërimit të nëndrejtorit të IPAP-së nga drejtori i IPAP-së

1. Drejtori i IPAP-së, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike.

2. Drejtori i IPAP-së, brenda tri ditëve pune pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Komisioni, interviston dy kandidatët.

3. Intervistat dokumentohen nga sekretari i institucionit ose nga një mësues i ngarkuar nga drejtori i IPAP-së dhe arkivohen në IPAP në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

4. Brenda tri ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët, drejtori i IPAP-së shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e nëndrejtorit të IPAP-së.

5. Kandidati jofitues ka të drejtë të paraqesë ankesë në ZVAP brenda tri ditëve pune nga shpallja e kandidatit fitues.

6. Drejtori i ZVAP-së shqyrton ankesën dhe jep përgjigjen brenda tri ditëve pune, pas përfundimit të afatit për ankim.

7. Drejtori i IPAP-së bën emërimin e nëndrejtorit të IPAP-së. Vendimi i emërimit i komunikohet zyrtarisht nëndrejtorit të sapoemëruar.

8. Nëndrejtori i IPAP-së nuk duhet të bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike.

Neni 8
Zëvendësimi i përkohshëm i drejtorit

1. Kur drejtori i IPAP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk e ushtron përkohësisht detyrën e tij, drejtori i DRAP-së cakton nëndrejtorin e këtij institucioni ose një mësues të IPAP-së, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit.

2. Kur vendi i drejtorit të IPAP-së shpallet i lirë, drejtori i DRAP-së cakton nëndrejtorin e këtij institucioni ose një mësues të IPAP-së, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit, deri në përfundim të procesit të konkurrimit sipas afateve të përcaktuara në kreun I, të këtij udhëzimi.

3. Tejkalimi i afateve të përcaktuara në kreun I, të këtij udhëzimi shoqërohet me masë disiplinore për drejtorin e ZVAP-së.

Neni 9
Raste të veçanta

1. Në rastet kur nuk paraqiten aplikantë për drejtor ose ka vetëm një aplikant, detyrën e drejtorit të IPAP-së e kryen përkohësisht drejtori zëvendësues, sipas nenit 8 të këtij kreu. Vendi për drejtor rishpallet sipas procedurës së mësipërme.

2. Në rastet kur nuk paraqiten aplikantë për nëndrejtor ose ka vetëm një aplikant, drejtori i IPAP-së rishpall vendin e lirë për nëndrejtor sipas procedurës së mësipërme.

3. Kur ka më shumë se dy kandidatë me numër të njëjtë pikësh, veçohen dy kandidatët për drejtor apo nëndrejtor që kanë marrë më shumë pikë në intervistën e strukturuar përpara Komisionit.

KREU II
PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS, ULJA NË DETYRË, PEZULLIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORIT DHE I NËNDREJTORIT TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 10
Mbarimi i marrëdhënies së punës së drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP-së

1. Marrëdhënia e punës për drejtorin apo nëndrejtorin e IPAP-së mbaron kur konstatohet njëri nga rastet e parashikuara në shkronjën "ç" të pikës 5 dhe shkronjën "ç" të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.

2. Në çdo rast marrëdhënia përfundon nëse konstatohet se drejtori apo nëndrejtori janë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale ose kur janë dënuar me vendim penal të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në

sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.

Neni 11
Procedura e shkarkimit dhe pezullimi i drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP-së

1. Në rastet e parashikuara në nënpikat "i" "ii", "iii", "iv", "v", "vii" dhe "viii" të shkronjës "c" të pikës 5, të nenit 55 të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, titullari i DRAP-së fillon procedurën për shkarkim të drejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative.

2. Në rast se konstatohet që pas emërimit drejtori i IPAP-së bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike, ndiqet procedura e parashikuar në nënpikën "vi" të shkronjës "c" të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar.

3. Për rastet e parashikuara në nënpikat "i" dhe "ii" të shkronjës "b", të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, nëse kanë filluar hetime paraprake ndaj drejtorit të IPAP-së, drejtori i DRAP-së, pas njoftimit zyrtar të drejtorit të ZVAP-së, merr vendimin e pezullimit të drejtorit të IPAP-së, deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente.

4. Drejtori i DRAP paralajmëron drejtorin e IPAP-së për shkarkim, kur provohet se ai nuk ka marrë masë për largim nga puna ndaj mësuesit, kur mësuesi ka kryer shkelje që parashikohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin që rregullon procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në IPAP. Drejtori i DRAP-së e shkarkon drejtorin kur e përsërit këtë veprim më shumë se një herë.

5. Në rastet e parashikuara në nënpikat "i" "ii", "iii" dhe "v", të shkronjës "c" të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, drejtori i IPAP-së fillon procedurën për shkarkim të nëndrejtorit duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative.

6. Në rast se konstatohet që pas emërimit, nëndrejtori i IPAP-së bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike, ndiqet procedura e parashikuar në nënpikën "iv" të shkronjës "c" të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar.

7. Drejtorit/nëndrejtorit të IPAP-së i jepet e drejta të dëgjohet nga titullari i institucionit para se të merret vendimi i shkarkimit të tij. Seanca dëgjimore dokumentohet dhe arkivohet.

8. Vendimi i drejtorit të DRAP/IPAP-së për pezullimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit/ nëndrejtorit të IPAP-së ruhet në arkivin e institucionit, në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

Neni 12
Ulja në detyrë e drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP-së

1. Në rast se, pas vlerësimit vjetor të performancës drejtori në detyrë i IPAP-së rezulton me performancë jo të kënaqshme, ZVAP-ja referon menjëherë vlerësimin në DRAP.

2. Drejtori i ZVAP-së, i jep të drejtën për t'u dëgjuar drejtorit që rezulton me performancë jo të kënaqshme brenda pesë ditëve nga njoftimi.

3. Pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, titullari i DRAP vendos uljen në detyrë të drejtorit të IPAP-së dhe kalimin e tij në pozicionin mësues në profilin e tij, brenda të njëjtit institucion arsimor ose në një institucion arsimor, brenda të njëjtit institucion arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar.

4. Në rast se pas vlerësimit vjetor të performancës së nëndrejtorit në detyrë i IPAP-së, ai rezulton me performancë jo të kënaqshme, ndaj tij merret masa e uljes në detyrë nga titullari i IPAP-së, i cili e referon menjëherë në institucionin arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, për kalimin e tij në pozicionin mësues në profilin e tij, brenda të njëjtit institucion arsimor ose në institucionin arsimor më të afërt, brenda së njëjtës ZVAP. Përpara marrjes së masës së uljes në detyrë, nëndrejtorit në detyrë të IPAP-së i jepet e drejta për t'u dëgjuar.

5. Drejtori në detyrë i IPAP-së kalon në pozicionin e punës si mësues në profilin e tij, në rast se në institucionin që drejton, ulet numri i nxënësve nën normën që përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Në institucionet arsimore parauniversitare me një nëndrejtor, në qoftë se ulet numri i nxënësve nën normën e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëndrejtori kalon në pozicionin e punës si mësues. Në rast se në institucionet arsimore parauniversitare publike që kanë më shumë se një nëndrejtor, ulet numri i nxënësve nën parashikimet ligjore në fuqi, suprimohet pozicioni i punës për një nëndrejtor dhe vijojnë procedurat e uljes në detyrë

për njërin nga nëndrejtorët duke vlerësuar dokumentacionin e tyre sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 6, të këtij udhëzimi. Nëndrejtori me më pak pikë do të kalojë në pozicionin e punës si mësues në profilin e tij, brenda të njëjtit institucion arsimor ose në institucionin arsimor më të afërt, brenda së njëjtës ZVAP.

KREU III
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13
Dispozita kalimtare

1. Përjashtimisht, për një periudhë dyvjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 44, datë 15.6.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar", kriteri i trajnimit dhe pajisjes me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor nuk është i detyrueshëm.

2. Në rast se kandidatët nuk plotësojnë kushtin sipas shkronjës "d", të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, kandidati fitues emërohet përkohësisht nga titullari i DRAP për drejtorin dhe titullari i IPAP-së për nëndrejtorin për një periudhë njëvjeçare. Pas përfundimit të kësaj periudhe, rishpallet procedura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucionit arsimor, sipas kreut I, të këtij udhëzimi.

3. Drejtorët dhe nëndrejtorët në detyrë të IPAP-ve, për vijimin e detyrës, përveç kritereve të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të nenit 2, të kreut I, të këtij udhëzimi, duhet të aplikojnë për t'u pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor dhe certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve.

Neni 14
Dispozita të fundit

1. Procedurat e emërimit, pezullimit, uljes në detyrë dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP-së janë objekt i inspektimit dhe i vlerësimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

2. Dispozitat e këtij udhëzimi nuk zbatohen për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit të institucionit publik të arsimit parashkollor.

3. Udhëzimi nr. 2, datë 28.1.2020, "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", të ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 3, datë 9.2.2022, "Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe të shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", shfuqizohen.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA NR. 1
JETËSHKRIMI

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME
a) emri, mbiemri
b) datëlindja
c) adresa
d) telefoni
e) *e-mail*
II. ARSIMIMI
III. PUNËSIMI
IV. KUALIFIKIMI
V. CERTIFIKATA

VI. BOTIMET
a) libra
b) shkrime
c) referime
VII. PROJEKTE
VIII. PROVIMET KOMBËTARE

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës nr. 1 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Nënshkrimi_____
Data _____

SHTOJCA NR. 2
FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emri, mbiemri	
Atësia/amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (numri)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: □ i/e padënuar. □ i/e dënuar

DEKLARUESI

_____
Emër Mbiemër/Firmë

Autorizim. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga DRAP/ZVAP.
Subjekti i autorizuar

_____ _____
Nënshkrimi i deklaruesit autorizues Vendi, data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale, sipas ligjit dhe sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

SHTOJCA NR. 3
DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT
TË APLIKANTIT PËR POZICIONIN E DREJTORIT APO NËNDREJTORIT TË IPAP-së

Deklaruesi: Z./Znj. _____
(emër, mbiemër)
Pozicioni aktual i punës: _____
Vendi i punës: _____

Unë nënshkruesi _____
(emër, atësia, mbiemër)

Kandidat për drejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar _____,

Sot, më datë ____.____._____, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se, _____ në kushtet e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të institucionit publik të arsimit parauniversitar _____, të parashikuara nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Vendi _____

Datë ____.____._____

Nënshkruesi _____
Emër Mbiemër/firmë

SHTOJCA NR. 4
DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT
TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT DHE VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT TË APLIKANTËVE PËR POZICIONIN E DREJTORIT APO NËNDREJTORTI TË IPAP-së

Deklaruesi: Z./Znj. _____
(emër, mbiemër)

Pozicioni në Komision: _____
Përfaqësuesi: _____

Unë nënshkruesi _____
(emër, atësia, mbiemër)

Kryetar/anëtar i Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve për pozicionin e drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar _____,

_____

Sot, më datë ____.____._____, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se, _____ në kushtet e konfliktit të interesit me aplikantët për pozicionin e drejtorit/nëndrejtorit të këtij institucioni publik të arsimit parauniversitar, të parashikuara nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Vendi _____

Datë ____.____._____

Nënshkruesi _____
Emër Mbiemër/firmë

Shënim. Deklarata plotësohet nga deklaruesi me shkrim dore.

SHTOJCA NR. 5
TABELA E TË DHËNAVE PËR APLIKANTIN

Emri dhe mbiemri _____
Aplikanti shënon brenda kllapave, krahas zërit përkatës:
- Numrin, kur kërkohet numri.
- "PO" ose "JO", kur kërkohet përgjigje e tillë.

Nr.	Përshkrimi	Rezultati
I	**ARSIMI**	
1	Arsim shtesë në fushën e arsimit (Po/Jo)	
2	Doktoratë (Po/Jo)	
3	Kredite në fushën e arsimit në 3 vjetët e fundit (numri i tyre)	
II	**LIBRA**	
1	Autor në tekstet shkollore (Po/Jo)	
2	Autor në tekstet për mësuesit (Po/Jo)	
3	Autor libri për drejtimin e shkollës (Po/Jo)	
4	Autor libri për çështje të tjera arsimore (Po/Jo)	
III	**SHKRIME**	
1	Shkrime për drejtimin e shkollës (Po/Jo)	
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (Po/Jo)	
IV	**KUMTESA**	
1	Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin (Po/Jo)	
V	**GJUHA E HUAJ E MBROJTUR**	
1	Gjuha angleze (Po/Jo)	
2	Gjuhë e huaj tjetër e vendeve të BE-së (Po/Jo)	
VI	**NOTAT**	
1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e cikli I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose ekuivalente me to).	
VII	**PROVIMET KOMBËTARE (provime lirimi ose matura shtetërore)**	
1	Administrator në provimet kombëtare (Po/Jo)	
2	Hartues i testeve në provimet kombëtare (Po/Jo)	
3	Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (Po/Jo)	
VIII	**VJETËRSI PUNE NË ARSIM/DREJTIM ARSIMI**	
1	Drejtor shkolle (vitet)	
2	Nëndrejtor (vitet)	
3	Vjetërsi si mësues (vitet)	

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës nr. 5 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Nënshkrimi Data

SHTOJCA NR. 6
TABELA E VLERËSIMIT PËR KANDIDATIN PËR DREJTOR APO NËNDREJTOR TË IPAP-së

1	**Nota mesatare e studimeve të larta** Llogaritet si mesatare aritmetike e të gjitha notave, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (mesatare e notave të ciklit I dhe notave të ciklit II), ose nota mesatare në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose ekuivalente me to), pjesëtuar me numrin 2 (dy) e rrumbullakosur me një shifër pas presjes. P.sh.: vlerësimi në pikë: nota mesatare 7.7 pjesëtim për 2 = 3.8 pikë.	0–5 pikë
2	**Shkallët e kualifikimit** Mësues i kualifikuar (kategoria III) 1 pikë (0.5 pikë për vlerësimin "Mirë"; 1 pikë për vlerësimet "Shumë mirë" ose "Shkëlqyeshëm") Mësues specialist (kategoria II) 2 pikë (1.5 pikë për vlerësimin "Mirë"; 2 pikë për vlerësimet "Shumë mirë" ose "Shkëlqyeshëm") Mësues mjeshtër (kategoria I) 3 pikë (2.5 pikë për vlerësimin "Mirë"; 3 pikë për vlerësimet "Shumë mirë" ose "Shkëlqyeshëm")	0.5–3 pikë
3	**Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja** a) gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 2 pikë b) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B1 = 2 pikë c) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B2 = 4 pikë Kur kandidati ka mbrojtur dy gjuhë të huaja të ndryshme në IAL-të publike, dy gjuhë të huaja të ndryshme me testim ndërkombëtar, niveli B1, vlerësohet 4 pikë. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 4 pikë në vlerësimin e dosjes. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.	0–4 pikë
4	**Certifikata trajnimesh** Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin në tri vitet e fundit. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) deri në 3 kredite = 1 pikë b) mbi 3 kredite = 2 pikë	0–2 pikë
5	**Vjetërsi pune në arsim** Vlerësohen deri në 25 vite pune. Vlerësimi i vjetërsisë në punë llogaritet duke pjesëtuar numrin e viteve të punës me 5 (pesë), me një shifër pas presjes, me rrumbullakosje, deri në maksimumi 5 pikë. P.sh.: vlerësimi në pikë: vjetërsia në punë 15.3 pjesëtim për 5 = 3.06 = 3 pikë, ose 16.4 vjet pjesëtim për 5 = 3.28 = 3.3 pikë etj. Kandidatët me më shumë se 25 vite punë vlerësohen me 5 pikë.	1–5 pikë
6	**Vjetërsi pune në pozicion drejtues** Deri 5 vite drejtor/nëndrejtor = 2 pikë Mbi 5 vite drejtor/nëndrejtor = 4 pikë	0–4 pikë
7	**Arsim shtesë** në fushën e arsimit	0–2 pikë
8	**Studime doktoratë** në fushën e arsimit	0–2 pikë
9	**Provimet kombëtare** - administrator/hartues testi/korrigjues teste kombëtare	0–1 pikë
10	**Autor në tekstet** shkollore/për mësuesit/për drejtimin e shkollës	0–1 pikë
11	**Shkrime** për drejtimin e shkollës/kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin	0–1 pikë
	Certifikatë për drejtues të IPAP nga Shkolla e Drejtorëve	10 pikë
12	**Intervista e strukturuar**	0–10 pikë
	SHUMA E PIKËVE	

Komisioni bën shpalljen rezultateve sipas tabelës së pikëve totale për të gjithë kandidatët, sipas shtojcës nr. 6.

SHTOJCA NR. 7
TABELA E REZULTATEVE

Nr.	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Pikë totale
1		
2		
3		

Komisioni

1. _____ _____ kryetar
(emër, mbiemër) (firma)
2. _____ _____ anëtar
3. _____ _____ anëtar
4. _____ _____ anëtar
5. _____ _____ anëtar

SHTOJCA NR. 8
DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë ..... kandidat në procesin e konkurrimit për drejtor/nëndrejtor në IPAP....., deklaroj në përgjegjësinë time se dokumentacioni i paraqitur nga ana ime për konkurrim është i vërtetë. Autorizoj DRAP/IPAP..... të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

KANDIDATI

_____

UDHËZUES 1
PËR PLOTËSIMIN E JETËSHKRIMIT

ARSIMIMI
Diploma/diplomat e shkollës së lartë
Doktoratë

KUALIFIKIMI
Kategoria e kualifikimit si mësues dhe vlerësimi i kualifikimit (nëse ka pasur vlerësim).
Nota mesatare.
Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e cikli I + nota mesatare e ciklit II/2), ose nota mesatare në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose ekuivalente me to.
Certifikata për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar, lëshuar nga Shkolla e Drejtorëve.
Certifikata për aspekte të tjera arsimore.
Shënim. Certifikatat mund të jenë marrë brenda ose jashtë vendit.

Ndër certifikatat e marra brenda vendit, vendosen vetëm ato që dëshmojnë marrjen e krediteve në 3 vitet e fundit.

PUNËSIMI
Renditen, njëra pas tjetrës, të gjitha punësimet, duke filluar nga e tanishmja deri tek punësimi i parë.
Për çdo punësim shkruhet:
- Viti i fillimit dhe i mbarimit të tij;
- Titulli i vendit të punës (mësues i matematikës në arsimin bazë, mësues i arsimit fillor, nëndrejtor, drejtor shkolle, inspektor etj.);
- Adresa e vendit të punës;
- Drejtor/nëndrejtor (shënoni numrin e viteve duke filluar nga zeroja).

BOTIMET
Përmenden vetëm botime të cilat kanë të bëjnë me arsimin duke filluar nga 1 janari 1992. Për çdo botim shkruhet emri e mbiemri i bashkautorëve

(nëse ka), titulli i botimit, institucioni botues dhe viti i botimit.

Botimet ndahen në libra dhe shkrime.

LIBRA

Librat ndahen në:

- tekste shkollore;
- tekste për mësuesit;
- libra për drejtimin e shkollës;
- libra për çështje të tjera arsimore.

Secili prej katër llojeve të mësipërme të librave renditet me numrat 1, 2, ...

P.sh.:

Tekste shkollore

Nuk ka

Tekste për mësuesit

1. Me Agim Korabin; teksti i nxënësit "Fizika 7", shtëpia botuese "Egla", 1997.

Libra për drejtimin e shkollës

Nuk ka.

Libra për çështje të tjera arsimore

1. "Strategjitë e mësimdhënies dhe të të nxënit", shtëpia botuese "Egla", 2004.

2. "Braktisja e shkollës në qarkun e Shkodrës, shtëpia botuese "7 Marsi", 2010.

SHKRIME

Shkrimet ndahen në:

- Për drejtimin e shkollës;
- Për çështje të tjera arsimore.

Secili prej dy llojeve të mësipërme renditet me numrat 1, 2, ...

P.sh.:

Drejtimi i shkollës

1. "Drejtori i shkollës – menaxheri i saj", gazeta "Mësuesi", 2007.

2. "Reforma e drejtimit të shkollës te ne dhe në vendet fqinje", gazeta "Shekulli", 2011.

Çështje të tjera arsimore

Nuk ka.

KUMTESA

Përfshihen kumtesa në konferenca, simpoziume etj., të mbajtura jashtë vendit.

Për çdo referim tregohet emri e mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i kumtesës, emri i konferencës ose simpoziumit, vendi dhe viti i mbajtjes.

Secila prej tyre renditet me numrat 1, 2, ...

P.sh.:

Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin

1. "Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në veprimtari jashtëshkollore", konferenca "Fëmijët me aftësi të kufizuara", Bukuresht, botuar në revistën "Education for all", 2003.

PROVIMET KOMBËTARE

Administrator në provimet kombëtare (matura shtetërore ose provime kombëtare të arsimit bazë) (vitet)

Hartues i testeve në provimet kombëtare (matura shtetërore ose provime kombëtare të arsimit bazë) (vitet)

Vlerësues i testeve të nxënësve në provimet kombëtare (matura shtetërore ose provime kombëtare të arsimit bazë) (vitet)

VINI RE!

Për kategorinë e kualifikimit si mësues, diploma (diplomat) e shkollës së lartë, licencën dhe notat e shkollës së lartë, certifikata me kredite, libreza e punës, paraqiten kopje të tyre.

- Për librat paraqitet kopja e ballinës.
- Për shkrimet paraqiten kopje të faqes së parë.
- Për kumtesat paraqiten kopje të faqes së parë.
- Për provimet kombëtare paraqiten dëshmi të firmosura nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe ZVAP përkatëse.

UDHËZUES 2
PËR VLERËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TË APLIKIMIT NGA KOMISIONI I SHQYRTIMIT DHE VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT TË APLIKIMIT

Pranimi ose mospranimi i një aplikimi:

Komisioni nuk pranon aplikimet në të cilat mungon njëra nga këto dokumente, pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 8/b, të shkronjës C, dhe pikën 7/b, të shkronjës D, të kreut I.

- Kopje e diplomës/diplomave, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës/ve të shkollës së lartë;
- kopja e njësuar me origjinalin për kategorinë e kualifikimit si mësues;
- kopja e njësuar me origjinalin e certifikatave me kredite;
- vërtetimi që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore, sipas shtojcës 2;

- deklarata e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të institucionit.

Komisioni pranon aplikimet për çdo mungesë tjetër, por shënon me zero pikët për mungesat përkatëse. P.sh., për një botim, kumtesë etj., që nuk ka provat e kërkuara te shtojca 1, shënohet numri 0 (zero).

Përllogaritja e pikëve të intervistës së strukturuar

- Në fillim të intervistës së strukturuar, anëtarët e Komisionit hartojnë një listë prej 5 pyetjesh, të cilat vlerësohen me nga 10 pikë secila..

- Pyetjet e hartuara nga Komisioni janë të njëjta për të gjithë kandidatët që realizojnë intervistën e strukturuar.

- Secili anëtar i Komisionit bën vlerësim individual me 0–10 pikë për përgjigjen e dhënë nga kandidati për secilën pyetje.

- Mblidhen pikët e secilit anëtar. Shuma pjesëtohet me numrin e anëtarëve të Komisionit dhe rezultati rrumbullakoset deri në një numër pas presjes dhjetore.

Shuma e pikëve të anëtarëve të Komisionit për intervistën e një kandidati pjesëtohet me numrin e anëtarëve pjesëmarrës.

Ky numër vendoset te zëri "intervista" te shtojca 5.

Pikët e një kandidati

Për të plotësuar pikët e një kandidati, Komisioni bazohet te shtojca 4, duke verifikuar vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar, për të plotësuar shtojcën 5.

UDHËZIM
Nr. 694, datë 3.11.2023

PËR PROCEDURAT E PËRDITËSIMIN TË BAZËS SË TË DHËNAVE DHE ADMINISTRIMIN E PASURIVE KULTURORE TË VJEDHURA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 6, të nenit 130, shkronjës "r", të nenit 268, të ligjit nr. 27, datë 17.5.2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore",

UDHËZOJ:

I. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRDITËSIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat, në lidhje me përditësimin e Bazës së të Dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura" (në vijim referuar si "Baza e të Dhënave"), të paraqitura në bazën e të dhënave, të cilat janë në ruajtje nga autoritetet përgjegjëse, deri në momentin që iu kthehen pronarëve të ligjshëm apo përfaqësuesve të tyre, në përputhje me pikën 6, të nenit 130, të ligjit nr. 27, datë 17.5.2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

2. Baza e të dhënave krijohet nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK), në përputhje me dispozitat e nenit 130, të ligjit nr. 27, datë 17.5.2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 583, datë 6.10.2021, "Për procedurat e krijimit dhe të administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë".

II. PËRKUFIZIME

Për qëllimet e këtij udhëzimi termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. "Baza e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura" është mbledhja/grumbullimi i organizuar i informacionit lidhur me pasuritë kulturore të luajtshme të vjedhura, të hyra ose të dala në mënyrë të paligjshme dhe/ose trafikuar, në ose brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij, kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik, sipas parashikimeve të nenit 130, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.

2. "Administrim i bazës së të dhënave" është menaxhimi i bazës së të dhënave, që përfshin të gjithë profilet e hyrjes në sistemin e bazës së të dhënave, në veçanti përditësimin dhe ndryshimin e informacionit të ruajtur në të.

3. "Institucion administrues" është IKRTK-ja, i cili është përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave, në përputhje me ligjin nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", VKM nr. 583, datë 6.10.2021, "Për krijimin e bazës së të dhënave për pasurinë kulturore të vjedhura", dhe këtë udhëzim;

4. "Dhënësit e informacionit" janë subjektet publike, private ose ndërkombëtare, siç përcaktohet në pikën 3, të nenit 130, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", VKM-në nr. 583, datë 6.10.2021, "Për procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë", dhe këtë udhëzim, për të siguruar informacione në bazën e të dhënave, përkatësisht: IKRTK-ja, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe institucionet në varësi të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe institucionet në varësi të saj, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet publike kombëtare që kanë në pronësi dhe administrojnë fonde të pasurive kulturore, bashkësitë fetare dhe organizmat ndërkombëtarë që operojnë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre edhe trashëgiminë kulturore;

5. "Ndërveprimi" është procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet bazave të të dhënave.

III. ADMINISTRIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Baza e të dhënave administrohet nën përgjegjësinë e Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, i cili është "institucioni administrues", me të drejtën ekskluzive të të gjitha profileve të hyrjes në sistem, veçanërisht përditësimin dhe ndryshimin e informacionit të ruajtur në të.

2. Nëpërmjet zyrave të saj, IKRTK-ja është përgjegjëse për:

a) sigurimin korrekt dhe përditësimin përkatës të të dhënave, si dhe zhvillimin e sistemit kompjuterik, në përputhje me standardet ndërkombëtare;

b) sigurimin e një qarkullimi të përshtatshëm të informacionit, në bazën e të dhënave të INTERPOL-it, për pasuritë kulturore që rezultojnë të vjedhura.

IV. MËNYRAT E PËRDITËSIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Përditësimi i bazës së të dhënave kryhet nga IKRTK-ja si organ administrues me autoritetin për të ndryshuar informacionin në të.

2. Informacioni që përbën bazën për ndryshimin e bazës së të dhënave sigurohet nga IKRTK-ja, ose nga dhënësit e informacionit, ose institucione ndërkombëtare, bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore, siç përcaktohet në VKM-në nr. 583/2021, "Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë".

3. Një objekt i pasurisë kulturore i renditur në bazën e të dhënave, hiqet prej saj nga IKRTK-ja, në rastet kur paraqitet një kërkesë e institucioneve publike ose në vijim të dorëzimit vullnetar, nga ana e subjekteve që posedojnë pasuri të përfshira në këtë bazë të të dhënave. Poseduesi, i cili dorëzon pasurinë kulturore mund të mbetet anonim vetëm nëse ai/ajo e dorëzon objektin brenda 3 (tre) viteve nga momenti i renditjes së objektit në bazën e të dhënave, përndryshe duhet të deklarojë të dhënat personale.

4. Procedura për dorëzimin vullnetar të pasurisë kulturore, të renditur në bazën e të dhënave kryhet në përputhje dispozitat e kreut XIII të këtij udhëzimi.

V. MËNYRA E PASURIMIT ME TË DHËNA NGA DHËNËSIT E INFORMACIONIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, institucionet në varësi, si edhe çdo agjenci tjetër e zbatimit të ligjit, janë të detyruara të pasurojnë bazën e të dhënave, në mënyrat dhe përcaktimet e parashikuara më poshtë, nga momenti i marrjes së njoftimit për veprën penale të kryer në lidhje me vjedhjen e pasurisë kulturore apo trafikimin e paligjshëm të saj dhe deri në rikuperimin e saj, duke përfshirë dhe pasurinë/pasuritë kulturore, që u përkasin vetëm institucioneve publike, të pakthyera nga dalja e përkohshme e tyre apo të hyra në mënyrë të paligjshme.

2. Rikuperimi i pasurisë kulturore që është përfshirë në bazën e të dhënave, konsiderohen si rastet e dorëzimit vullnetar nga poseduesi në polici ose nga agjenci të tjera të zbatimit të ligjit, si edhe rastet e konfiskimit të pasurive të tilla nga agjenci ligjzbatuese. Informacioni mbi rikuperimin në fjalë do të sjellë si rezultat, heqjen e pasurisë kulturore të rikuperuar nga baza e të dhënave.

3. Të dhënat që do të komunikohen nga autoritetet e parashikuara në pikën 1 të këtij kreu paraqiten sipas shtojcës "A" (seksionet "A" dhe "B") të VKM-së nr. 583/2021, "Për procedurat për

krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë", dhe përfshijnë elementet e identifikimit, si më poshtë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duhet të përfshijë:

Të dhënat e ngjarjes:

i. kodi i ngjarjes/numër reference;

ii. zyra e cila ka marrë raportin e ngjarjes ose e raporton atë;

iii. protokolli i zyrës proceduese;

iv. referenca e bazës së të dhënave;

v. data e aktit;

vi. data e ngjarjes;

vii. ankuesi;

viii. vendi ku është kryer vepra penale;

ix. qarku;

x. bashkia;

xi. njësia administrative;

xii. adresa;

xiii. raportimin e ngjarjes ku ndodhi vjedhja, apo dalja apo hyrja e paligjshme e pasurisë kulturore;

xiv. skeduesi;

xv. data e skedimit;

b). Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (për objektet që janë të regjistruara në RKPK) dhe përfshijnë:

Të dhëna mbi objektin:

i. kodi i objektit;

ii. lloji i objektit;

iii. teknika;

iv. materiali;

v. gjatësia;

vi. gjerësia;

vii. lartësia;

viii. diametri;

ix. pesha;

x. vlera;

xi. periudha;

xii. titulli;

xiii. autori;

xiv. numri i inventarit;

xv. kodi RKPK.

Galeria e objektit:

i. dokumentacioni administrativ (urdhra, vendime);

ii. dokumentacioni fotografik për objektet;

iii. dokumentacioni audiovizual për objektet e trashëgimisë materiale ose jomateriale;

iv. emërtimi;

v. madhësia;

vi. lloji;

vii. pamja ballore.

Statusi:

i. status autenciteti;

ii. i humbur;

iii. status dëmtimi;

iv. trashëgimi;

v. aprovuar;

vi. miratuar;

Historiku:

i. titulli;

ii. historiku;

iii. bibliografia.

Përshkrime:

i. akademik;

ii. përshkrimi;

iii. të tjera.

Për pasuritë kulturore që i nënshtrohen daljes apo hyrjes së paligjshme te të dhënat që përfshijnë këto pasuri duhet të jenë edhe:

i. numri i licencës së qarkullimit lirë apo të përkohshëm lëshuar nga IKRTK-ja;

ii. vlerësimi ekonomik i dëmtimit të pasurisë së luajtshme (nëse është i mundur);

iii. elementet e mbulimit të sigurimit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, institucionet në varësi, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij kreu, i komunikojnë IKRTK-së, me anë të komunikimit elektronik të dhënat e referuara, sipas parashikimeve nën të njëjtin nen, në lidhje me vjedhjen ose daljen, ose hyrjen e paligjshme dhe/ose pasurinë kulturore të trafikuar, ose moskthimin e pasurive brenda afatit të paraqitur në licencën e qarkullimit të përkohshëm, dhe në çdo rast jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga momenti i marrjes në dijeni të kryerjes së veprës penale apo shkeljes në fjalë. Të gjitha të dhënat që vendosen në dispozicion nga Policia e Shtetit dhe nga personeli doganor i strukturave hetimore, luftës kundër kontrabandës dhe trafikut të paligjshëm dhe i strukturave të tjera doganore, që përcaktohen me ligj specifik, të cilat kanë atributet e Policisë Gjyqësore, sipas nenit 7, paragrafi 4, të Kodit Doganor, miratohen paraprakisht nga prokurori i çështjes.

Brenda 20 (njëzet) ditësh, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, institucionet në varësi

dhe çdo agjenci tjetër e zbatimit të ligjit, referuar parashikimeve në pikën 1 të këtij kreu, do t'i komunikojnë IKRTK-së, çdo ndryshim të të dhënave që janë të nevojshme në vijim pas rikuperimit të pasurisë kulturore, duke plotësuar formularin sipas shtojcës B të VKM-së nr. 583/2021, "Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë".

VI. FURNIZIMI ME INFORMACION NGA INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

1. Institucionet ndërkombëtare bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave, në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore, mund të sigurojnë informacione për IKRTK-në, në lidhje me pasuritë kulturore që hyjnë ose dalin në mënyrë të paligjshme dhe/ose trafikohen brenda dhe jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë.

2. IKRTK-ja, nëpërmjet organeve kompetente, i drejton një kërkesë një vendi tjetër ku dyshohet se pasuria kulturore ka dalë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke identifikuar poseduesin e saj. Kërkesa duhet të përmbajë informacionin e hollësishëm të përshkrimit të pasurisë kulturore dhe çdo informacioni tjetër për të lehtësuar kërkimin, si dhe vendndodhjen aktuale apo të dyshuar të pasurisë kulturore të kërkuar.

3. Në të njëjtën mënyrë, Republika e Shqipërisë do të informojë një vend tjetër, kur një pasuri kulturore e atij vendi gjendet në territorin e saj dhe kur ka dyshim të arsyeshëm të besohet se kjo pasuri kulturore është vjedhur, trafikuar ose importuar në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Baza e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, do të ndërveprojë me baza të ngjashme të të dhënave nga vendet e tjera ose organizatat ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, bazuar në një mandat të qartë ligjor, në një mënyrë të automatizuar për të shkëmbyer informacionin primar me ta.

VII. FAZAT E MENAXHIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Procesi i menaxhimit të bazës së të dhënave nga IKRTK-ja, ndahet në aktivitetet kryesore të mëposhtme, për sa i përket fazës së furnizimit me informacion të tij:

a) marrja e komunikimeve;

b) verifikimi i përmbajtjes së komunikimeve, në lidhje me qëllimet e përcaktuara në kreun III të këtij udhëzimi;

c) regjistrimi i të dhënave pas miratimit nga IKRTK-ja;

d) komunikimi që të dhënat nuk janë në përputhje me qëllimet e parashikuara;

e) konsultimi nga/me subjektet e autorizuara.

2. IKRTK-ja, pas marrjes së të dhënave, verifikon nëse ato janë plotësuar sipas mënyrës së përcaktuar në VKM-në nr. 583/2021 dhe këtij udhëzimi. Nëse nga verifikimi rezulton se të dhënat e plotësuara janë në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 583/2021, "Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë" dhe këtij udhëzimi, atëherë IKRTK-ja i miraton ato brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së të dhënave. Nëse nga verifikimi rezulton se të dhënat nuk janë plotësuar si duhet nga ana e dhënësve të informacionit sipas dispozitave të VKM-së nr. 583/2021, "Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë" dhe këtij udhëzimi, atëherë IKRTK-ja nuk i miraton këto të dhëna pa u plotësuar më parë mangësitë teknike apo ato përshkruese. IKRTK-ja ka detyrim të njoftojë menjëherë dhënësit e informacionit për mungesën apo mangësive në plotësimin e të dhënave. Dhënësit e informacionit duhet të plotësojnë mangësitë e identifikuara nga IKRTK-ja brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e kërkesës.

VIII. STRUKTURA E PËRGJITHSHME E BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Baza e të dhënave është e ndarë në fusha të ndryshme tematike, për shkak të funksioneve të ndryshme që ajo kryen, të cilat korrespondojnë me të njëjtin numër detyrash të kryera nga personeli përgjegjës për furnizimin e të dhënave dhe konsultimin, që synon verifikimin e pasurisë, pavarësisht nëse është vjedhur ose jo:

a) "Regjistrimi i të dhënave" kushtuar krijimit të "ngjarjes", të lidhur me pasurinë kulturore me të cilën shoqërohet emri i pronarit/ve të ligjshëm të pasurisë kulturore

b) "Kërkim/konsultim" kushtuar kërkimit të të dhënave aktuale, si dhe krahasimit të imazheve të pasurisë kulturore, të cilat gjenden në bazën e të dhënave me ato që duhen verifikuar në bazë të raporteve të gjeneruara nga institucionet përgjegjëse (Policia e Shtetit, zyrat doganore dhe/ose agjenci të tjera ligjzbatuese, të cilat kanë qasje të plotë në bazën e të dhënave) ose të paraqitura nga individë privatë, duke plotësuar më parë formularin e kërkesës për verifikimin privat sipas shtojcës C" të VKM-së nr. 583/2021, "Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë";

c) "Statistikat" kushtuar analizës, studimit dhe kërkimit të "ngjarjeve" të krijuara, referuar në pikën a të këtij neni, të ndarë sipas periudhës kohore (p.sh. krahasimi sipas vitit/muajit) dhe referuar në të gjithë territorin kombëtar ose sipas zonës gjeografike (prefektura, komuna, njësia administrative etj.);

d) "Administrimi" kushtuar menaxhimit teknik të sistemit të informacionit të bazës së të dhënave.

IX. SISTEMI I REGJISTRIMIT TË TË DHËNAVE DHE PËRDITËSIMI I TYRE

1. Në fushën tematike "Regjistrimi i të dhënave", duhet të regjistrohet informacioni në lidhje me furnizimin/përditësimin e "ngjarjes", për:

a) "Pasurinë kulturore" të përcaktuar sipas neneve 50 dhe 51 të ligjit nr. 27/2018, për t'u kontrolluar (furnizimi i informacionit);

b) Refuzimet për lëshimin e licencës së qarkullimit të lirë, në përputhje me dispozitat e nenit 125 të ligjit 27/2018 (furnizimi i informacionit);

c) Rikuperimi/vendndodhja/sekuestrimi i pasurisë kulturore, sipas pikës "a", të vjedhur në rast të zbulimit (përditësimit) të tyre vijues;

d) Fakte të tjera, si:

i. Zbulimi i gërmimeve të paligjshme;

ii. Dëmtimi i pasurisë kulturore të paluajtshme (monumenteve, ndërtesave historike), qoftë nga njeriu ose si rezultat i katastrofave natyrore;

e) Gjenerimi dhe përditësimi i të dhënave mbi vendet dhe njerëzit që kanë lidhje me ngjarjen (përfshirja e të cilëve është thelbësore për krijimin e ngjarjes).

2. Pas raportimit/furnizimit me informacion mbi vjedhjen e pasurisë kulturore të Republikës së Shqipërisë së hyrë/dalë në mënyrë të paligjshme, operatori i bazës së të dhënave do të:

a) Kontrollojë fillimisht nëse pasuria kulturore duhet të kërkohet dhe më pas të sigurohet nëse ngjarja është e regjistruar në bazën e të dhënave. Nëse jo, të krijohet një "ngjarje e re", e cila përmban të dhënat e mëposhtme:

i. llojin e veprës penale të kryer (vjedhje, grabitje, mashtrim, përvetësim nga jakat e bardha, dalje/ eksport apo hyrje/import e paligjshëm etj.) ose, nëse është një pasurisë kulturore e humbur (e cila ka dalë p.sh. si rezultat i inventarit);

ii. periudha kohore (data/fillimi dhe data/ mbarimi, nëse dihet) e kryerjes së veprës penale ose humbjes së pasurisë kulturore;

iii. raporti përkatës/të dhënat e raportit:

iv. Zyra e Raportimit (drejtoria rajonale e trashëgimisë kulturore, policia, zyra doganore etj.);

v. data e dorëzimit;

vi. protokolli kompjuterik (nëse raporti është regjistruar në bazën e të dhënave të Policisë së Shtetit);

a) Vendndodhja e ngjarjes (muze, galeri artesh, dyqan antikash, shtëpi private, vend adhurimi, etj.);

b) Personi fizik zakonisht i njëjtë me paditësin: kontrollohet nëse të dhënat mbi personin janë apo jo në bazën e të dhënave. Nëse jo, gjenerohet një "person i ri fizik", duke vendosur të dhënat personale emrin, mbiemrin, vendin dhe datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit, adresën e vendbanimit dhe kontaktet personale (numër telefoni dhe adresë *e-mai*-li);

c) Dokumentet: Komunikimi i zyrës që raporton, kthehet në formatin PDF dhe ngarkohet në sistemin e informacionit;

d) Për identifikimin e saktë të pasurisë kulturore dhe kompjuterizimin duhet të plotësohen të dhënat e mëposhtme:

i. Sasia (zakonisht korrespondon me 1, sepse pasuritë kulturore duhet të regjistrohen një nga një);

ii. Konteksti i veprës artistike (paleontologjike, arkeologjike, antike, moderne, bashkëkohore);

iii. Lloji i objektit (përshkrimi i shkurtër i asaj se çfarë është objekti në fjalë. Ky informacion mund të sigurohet nga një fjalë e vetme. Shembuj: ikonë, pikturë, kupë, libër, statujë, shpatë, vazo, unazë, grafikë, gjetje arkeologjike, dokument, dorëshkrim arkivor, krijim i kabinetit etj.) dhe subjekti (specifikoni objektin/subjektin e saktë të përfaqësuar nga pasuria kulturore);

iv. Materiali (letër, dru, kanavacë, lloj metali, qelq, gur, pëlhurë etj.);

v. Teknika e ekzekutimit (vaj, bojë tempera, pastel, mozaik, serigrafi, litografi, mënyra të përziera, me reliev të lartë, basoreliev, gdhendje me daltë, gdhendje në reliev, zbukurime me disa materiale (inlay) etj.)

vi. Përmasat: (lartësia: _____ cm; bazë: ____cm; thellësia: _____cm; diametri: _____; pesha në_____ kg). Në rastin e formave komplekse ose të pazakonta, tregoni matjet në këtë renditje: lartësia x gjerësia, x thellësia;

vii. Formati: specifikoni nëse forma është horizontale, vertikale, e rrumbullakët, ovale ose të tjera;

viii. Autori (nëse dihet shkruani "nënshkruar nga ...", ose "atribuohet për ...", ose "Shkolla e ...", koha e ekzekutimit - tregoni shekullin dhe, nëse dihet, vitin); Informacion që përcakton origjinën e ekzistencës materiale të veprës artistike: identitetin e artistit; koha kur artisti krijoi veprën artistike ose kur u prodhua objekti antik; dhe në fund vendi ku u krijua. Ky informacion përcakton origjinën e objektit dhe origjinalitetin e tij. Nëse veprat janë produkte bashkëpunimi ose kopje, tregoni artistët ose artistin e kopjuar, nëse dihet. Nëse vepra i atribuohet vetëm një artisti të vetëm, shkruani "I atribuohet […]". Në rastin e materialeve të shtypura, shënoni emrin e botuesit, vendin dhe vitin e botimit.

ix. Koleksion: konsiderohet si një koleksion një grup objektesh, punimesh ose dokumentesh të ndryshme, që formojnë një unitet kulturor dhe që nuk mund të shkëputen pa dëmtuar koherencën e tij, dhe për të cilat vlera e kombinuar është më e madhe se shuma e vlerave individuale të elementeve përbërës të tij. Së bashku me identifikimin dhe vlerësimin e nevojshëm të secilit prej përbërësve të tij, jepni një arsyetim që prona të trajtohet si një koleksion.

x. Titulli i veprës artistike (nëse dihet). Ndonjëherë objekti nuk do të ketë titull zyrtar, por është bërë i njohur me një emër specifik. Kur kjo nuk përfshihet në formulimin e titullit, "subjekti" e përshkruan atë që objekti kulturor synon të përfaqësojë. Shembuj: portret; figurë më këmbë e një njeriu; prapaskena e jashtme me një qen; peizazhi me anije etj.;

xi. Përshkrimi përmbledhës i pasurisë kulturore;

xii. Fotografi: fotografia me ngjyra (të paktën 9×12 cm). Për të lehtësuar identifikimin e objekteve tredimensionale, mund të kërkohen pamje të ndryshme të pasurisë kulturore (ballore, anësore dhe nga prapa). IKRTK-ja mund të kërkojë fotografi të tjera shtesë;

xiii. Informacione të tjera (katalogimi/numri i inventarit, vlera, mbulimi nga sigurimi, referenca e bazës së të dhënave të INTERPOL-it, publikimi i mundshëm në një faqe të jashtme në internet për publikun etj.).

b) Plotësimi i të dhënave mbi refuzimet për të lëshuar licencën e qarkullimit të lirë ose të përkohshëm, sipas ligjit nr. 27/2018 (furnizimi i informacionit) që gjeneron një "ngjarje të re". "Ngjarja e re" përmban të dhënat e mëposhtme:

i. numrin e protokollit, datën e lëshimit dhe zyrën që ka lëshuar refuzimin;

ii. datën e dorëzimit (dhe numri i protokollit në mbërritje, nëse ka) të kërkesës për licencë qarkullimi të lirë;

iii. datën e revokimit të numrit të refuzimit/ protokollit, nëse ka, dhe tregues për zyrën, e cila ka revokuar vendimin;

iv. vendin e ngjarjes (korrespondon me vendin ku ndodhet pasuria kulturore në momentin e paraqitjes së kërkesës);

v. personin fizik (zakonisht i njëjtë me aplikantin/pronarin ose me ndonjë ndërmjetës: kontrolloni nëse personi është apo jo i pranishëm në bazën e të dhënave, nëse jo, gjenerohet një "person i ri fizik") duke vendosur emrin, mbiemrin, vendlindjen dhe datën e lindjes, adresën e vendbanimit dhe kontaktet personale (numër telefoni dhe adresë elektronike/*email*-i);

vi. dokumentet: komunikimi i zyrës së raportimit kthehet në formatin PDF dhe futet në sistemin e informacionit;

vii. pasurinë kulturore, për identifikimin e saktë duhet të plotësohen të dhënat e mëposhtme:

a) Sasia (zakonisht korrespondon me 1 sepse pasuritë kulturore duhet të regjistrohen një nga një);

b) Konteksti i veprës artistike (paleontologjike, arkeologjike, antike, moderne, bashkëkohore);

c) Lloji i objektit (përshkrimi i shkurtër i asaj se çfarë është objekti në fjalë; ky informacion mund të sigurohet nga një fjalë e vetme. Shembuj: ikonë, pikturë; kupë; libër; statujë; shpatë; vazo; unazë, grafikë, gjetje arkeologjike, dokument, dorëshkrim arkivor, krijim i kabinetit etj.) dhe subjekti (specifikoni objektin/subjektin e saktë të përfaqësuar nga pasuria kulturore);

d) Materiali (letër, dru, kanavacë, lloj metali, qelq, gur, pëlhurë etj.);

e) Teknika e ekzekutimit (vaj, bojë tempera, pastel, mozaik, serigrafi, litografi, mënyra të përziera, me reliev të lartë, basoreliev, gdhendje me daltë, gdhendje në reliev, zbukurime me disa materiale *(inlay)* etj.)

f) Përmasat: (lartësia: _____ cm; bazë: ____cm; thellësia: _____cm; diametri: _____; pesha në_____ kg). Në rastin e formave komplekse ose të pazakonta, tregoni matjet në këtë renditje: lartësia x gjerësia, x thellësia;

g) Formati: specifikoni nëse forma është: horizontale, vertikale, e rrumbullakët, ovale ose të tjera;

h) Autori (nëse dihet shkruani "nënshkruar nga ...", ose "atribuohet për ...", ose "Shkolla e ...", koha e ekzekutimit - tregoni shekullin dhe, nëse dihet, vitin); informacion që përcakton origjinën e ekzistencës materiale të veprës artistike: identitetin e artistit; koha kur artisti krijoi veprën artistike ose kur u prodhua objekti antik dhe në fund vendi ku u krijua. Ky informacion përcakton origjinën e objektit dhe origjinalitetin e tij. Nëse veprat janë produkte bashkëpunimi ose kopje, tregoni artistët ose artistin e kopjuar, nëse dihet. Nëse vepra i atribuohet vetëm një artisti të vetëm, shkruani: "I atribuohet […]". Në rastin e materialeve të shtypura, shënoni emrin e botuesit, vendin dhe vitin e botimit.

i) Koleksion: konsiderohet si një koleksion një grup objektesh, punimesh ose dokumentesh të ndryshme, që formojnë një unitet kulturor dhe që nuk mund të shkëputen pa dëmtuar koherencën e tij, dhe për të cilat vlera e kombinuar është më e madhe se shuma e vlerave individuale të elementeve përbërëse të tij. Së bashku me identifikimin dhe vlerësimin e nevojshëm të secilit prej përbërësve të tij, jepni një arsyetim që prona të trajtohet si një koleksion.

j) titulli i veprës artistike (nëse dihet). Ndonjëherë objekti nuk do të ketë titull zyrtar, por është bërë i njohur me një emër specifik. Kur kjo nuk përfshihet në formulimin e titullit "subjekti" e përshkruan atë që objekti kulturor synon të përfaqësojë. Shembuj: portret; figurë më këmbë e një njeriu; prapaskena e jashtme me një qen; peizazhi me anije etj.;

k) Përshkrimi përmbledhës i pasurisë kulturore;

l) Fotografi: fotografia me ngjyra (të paktën 9×12 cm). Për të lehtësuar identifikimin e objekteve tredimensionale, mund të kërkohen pamje të ndryshme të pasurisë kulturore (ballore, anësore dhe nga prapa). IKRTK-ja mund të kërkojë fotografi të tjera shtesë;

m) Shënime (fusha me tekst të lirë për të vendosur informacione të vlefshme me interes).

c) Në rastin e rikuperimit/ vendndodhjes/ konfiskimit të pasurive kulturore, në varësi të kërkimit të përmendur në pikën "a", përditësohet sistemi kompjuterik, duke kontrolluar paraprakisht nëse pasuritë janë të pranishme apo jo në bazën e të dhënave. Nëse pasuritë kulturore nuk janë në bazën e të dhënave, duhet të krijohet një "ngjarje e re", në mënyrë që të mund të vendoset ngjarja "rikuperim/vendndodhje/konfiskim". Sapo të jenë identifikuar pasuritë kulturore për t'u rikuperuar, operatori duhet të regjistrojë:

i. datën e rikuperimit;

ii. vendin e rikuperimit;

iii. zyrën përgjegjëse që e ka proceduar këtë rast;

iv. përllogaritjen e vlerës së pasurisë kulturore (nëse ka);

v. shënime (fusha me tekst të lirë për informacione me interes).

d) Në rast të fakteve të tjera si p.sh.:

i. Zbulohen gërmime të paligjshme (nuk janë të autorizuara në përputhje me pikën 8, të nenit 133, të ligjit nr. 27/2018), duhet të gjenerohet një "ngjarje e re", në të cilën duhet të vendosen të dhënat e mëposhtme:

a. lloji i ngjarjes (ngjarje të tjera);

b. kategoria e ngjarjes (gërmime të paligjshme);

c. lloji i shkeljes (administrative lidhur me kërkimet dhe zbulimet e artefakteve arkeologjike, në përputhje me pikën "a" të nenit 260 të ligjit nr. 27/2018);

d. data e ngjarjes (lidhur me zbulimin);

e. vendi i ngjarjes (identifikoni bashkinë dhe njësinë administrative dhe emrin e zonës arkeologjike);

f. zyra e raportimit (Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Policia e Shtetit etj.);

g. shënime (fusha me tekst të lirë për informacion me interes, siç mund të jenë të dhënat mbi koordinatat gjeografike të vendndodhjes së saktë të gërmimeve të paligjshme);

h. instrumente kërkimore arkeologjike të sekuestruara (tregoni llojin dhe sasinë e instrumenteve të sekuestruara);

i. dokumentet: komunikimi i zyrës së raportimit kthehet në formatin PDF dhe ngarkohet në sistemin e informacionit;

j. trashëgimia kulturore: vetëm në rast të zbulimit të objekteve kulturore ose fragmenteve të tyre, procedohet me vendosjen;

ii. Dëmtimi i trashëgimisë kulturore të paluajtshme (monumente, ndërtesa historike), qoftë nga njeriu ose si rezultat i katastrofave natyrore - gjenerohet një "ngjarje e re", në të cilën vendosen të dhënat e mëposhtme:

a. lloji i ngjarjes (ngjarje të tjera);

b. kategoria e ngjarjes (dëmtimi nga njeriu/ shkaqet natyrore);

c. lloji i shkeljes (specifikoni nëse përbën vepër penale);

d. data e ngjarjes (lidhur me ngjarjen);

e. vendi i ngjarjes (specifikoni bashkinë, njësinë administrative dhe vendin: p.sh. kisha, monumenti, muzeu, ndërtesa historike etj.);

f. zyra e Raportimit (Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Policia e Shtetit etj.);

g. shënime (fusha me tekst të lirë për informacione me interes);

h. dokumentet: komunikimi i Zyrës së raportimit kthehet në formatin PDF dhe ngarkohet në sistemin e informacionit;

i. pasuri kulturore: specifikoni vetëm nëse dëmtohen ato pasuri të vendosura brenda strukturës (p.sh. piktura, skulptura brenda muzeut).

X. SISTEMI I KËRKIMEVE DHE KONSULTIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Fusha tematike "Kërkim/konsultim" i kushtohet kërkimit të të dhënave të pranishme, si dhe krahasimit (automatik dhe manual) të imazheve (nëse ka) të pasurisë kulturore në bazën e të dhënave me ato që do të verifikohen në bazë të raporteve (shoqëruar me fotografi, të institucioneve publike (policia, doganat, drejtoria rajonale e trashëgimisë kulturore etj.) ose të paraqitura nga individë privatë përmes plotësimit të formularit të kërkesës, është strukturuar duke respektuar të njëjtat fusha të përdorura te "Regjistrimi i të dhënave", referuar kreut IX.

2. Operatori mund të përdorë fushën e kërkimit "tekst i lirë", i cili i lejon të ketë një gamë të gjerë rezultatesh.

XI. STATISTIKAT DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Zona tematike "Statistika" i kushtohet përpunimit dhe analizimit të të dhënave të mbledhura në bazë të përcaktimit të një periudhe kohore (data e fillimit dhe e mbarimit) dhe një zone të përcaktuar gjeografike që përzgjidhet lirisht nga operatori, në lidhje me vjedhjen, humbjen e pasurisë pas inventarit dhe gërmimeve të paligjshme.

XII. ADMINISTRATA

Fusha tematike "Administrata" i kushtohet nivelit më të lartë të menaxhimit të bazës së të dhënave nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, e ushtruar nga IKRTK-ja. Në lidhje me këtë funksion, titullari i institucionit:

a) Menaxhon drejtpërdrejt profilet e hyrjes së përdoruesve në sistem, duke dhënë autorizimin për t'u konsultuar dhe/ose për t'u gjeneruar "ngjarje të re" (me funksionin "Regjistrimi i të dhënave") te baza e të dhënave, ose revokimin e saj në lidhje me nevojat e ndryshuara të shërbimit konfidencialiteti i të dhënave të përmbajtura;

b) Autorizon përdoruesit të gjenerojnë/fshijnë fusha të reja për vendosjen/modifikimin e "regjistrave me tabela" të vendeve të reja, zyrave, autorëve të trashëgimisë kulturore (e cila ndodh kur është e nevojshme për të vendosur një bashki/zyrë të re që nuk ndodhet në bazën e të dhënave, ose një "autor të ri" të veprave artistike);

c) Siguron hartimin e një "Buletini periodik të veprave të vjedhura të artit", midis atyre që konsiderohen se meritojnë më shumë vëmendje për sa i përket rëndësisë së tyre, të cilat mund të zbulohen në format e gjykuara, si më të përshtatshme nga IKRTK-ja;

d) Autorizon transmetimin e të dhënave në lidhje me veprat e artit të cilat duhet të kërkohen në bazën e të dhënave të INTERPOL-it.

RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN E PASURIVE KULTURORE TË VJEDHURA

XIII. RIKUPERIMI I PASURIVE KULTURORE TË VJEDHURA

1. Një objekt i pasurisë kulturore, i cili është përfshirë në bazën e të dhënave mund të rikuperohet përmes dorëzimit vullnetar nga ana e subjekteve që posedojnë pasuri të përfshira në bazën e të dhënave, te Policia e Shtetit. Kjo e fundit, informon menjëherë IKRTK-në për këtë dorëzim vullnetar të pasurisë kulturore.

2. Në këtë rast, pasi të jenë verifikuar dhe regjistruar paraprakisht, rrethanat e blerjes së pasurisë kulturore të vjedhur nga personi që e dorëzon atë, si dhe informacione të tjera që vlerësohen të dobishme për procesin e verifikimit dhe konstatimit të fakteve, të cilat do t'u raportohen

më pas autoriteteve përgjegjëse gjyqësore, oficeri i policisë ose një zyrtar tjetër i agjencive ligjzbatuese merr hapat e mëposhtëm:

a) Nëse dorëzimi bëhet brenda 3 (tre) vjetësh nga botimi/regjistrimi i pasurisë kulturore në bazën e të dhënave, oficeri i policisë apo ndonjë zyrtar tjetër i agjencive ligjzbatuese harton një raport për dorëzimin vullnetar të pasurisë kulturore, me identifikimin e personit që e ka dhënë atë, por pa i komunikuar të dhënat personale të tij, IKRTK-së;

b) Informon menjëherë IKRTK-në, në mënyrë që të mund të kryejë një kontroll të bazës së të dhënave për të parë nëse objekti kulturor është në kërkim apo jo.

Nëse lindin dyshime të arsyeshme për origjinën e paligjshme të pasurisë kulturore të dorëzuar, kryejnë çdo veprim të nevojshëm që synon identifikimin e pronarit apo të përfaqësuesit të tij ligjor apo dhe poseduesit të ligjshëm për ndonjë arsye.

3. Në rast se pasuria e rikuperuar kulturore identifikohet në bazën e të dhënave, IKRTK-ja e heq atë nga kjo bazë të dhënash dhe punon së bashku me agjencitë e zbatimit të ligjit për të identifikuar pronarin apo përfaqësuesin e tij ligjor dhe shtetin e tij (kur është e mundur).

a) Nëse identifikohet pronari apo përfaqësuesi i tij ligjor, të cilit i përket pasuria kulturore dhe shteti, IKRTK-ja, në bashkëpunim me autoritetet e atij shteti, bazuar në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, nëse ka, merr masat për kthimin sa më të shpejtë të pasurisë kulturore te pronari apo përfaqësuesi i tij ligjor.

XIV. MASAT PËR RUAJTJEN DHE KUJDESIN E PASURISË KULTURORE

1. IKRTK-ja në bashkëpunim me institucionet e tjera të specializuara të trashëgimisë kulturore informon Policinë e Shtetit dhe pikat doganore kufitare, të cilat kanë në ruajtje pasurinë kulturore të sekuestruar, mbi të gjitha masat që synojnë ruajtjen e pasurisë kulturore të sekuestruar, sipas llojit të pasurisë kulturore dhe referuar legjislacionit në fuqi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ku ndër më të rëndësishmet janë si më poshtë:

a) Në çdo rast, duhen marrë masa për mënjanimin apo eliminimin e shkaqeve që shkaktojnë degradimin e materialeve nga të cilat përbëhet pasuria kulturore;

b) Pasuria kulturore duhet të vendoset në një dhomë të përshtatshme për ruajtjen e saj, duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

i. mosekspozim ndaj rrezatimit diellor;

ii. mosekspozim ndaj pluhurit të imët dhe ose agjentëve të tjerë kimikë;

iii. temperatura e ajrit të jetë ndërmjet 15°C dhe 20°C;

iv. niveli i lagështirës të jetë ndërmjet 40% dhe 55% (të merret parasysh rast pas rasti në lidhje me kushtet klimatike të vendit të magazinimit dhe në lidhje me llojin e pasurisë kulturore që ruhet);

v. mosekspozim ndaj shtypjes së tepërt mekanike dhe/ose mbrojtjes nga rreziku i rënies aksidentale të pasurisë kulturore në ruajtje dhe ose të objekteve të tjera mbi të;

c) ruajtjen e pasurive kulturore në një vend i cili mbrohet me sisteme të përshtatshme kundër zjarrit dhe me kamera, si dhe ku aksesi për publikun është i ndaluar ndërsa aksesi për personelin që punon to është i kufizuar në pak njerëz, hyrja e të cilëve në çdo rast duhet të jetë e monitoruar;

d) Regjistrimin e të dhënave kryesore të pasurive kulturore në një regjistër të veçantë, të cilat janë nën kujdes, si dhe regjistrimin e të dhënave personale të personit që i ka dorëzuar ose nga i cili është sekuestruar, datën, orën dhe vendin e dorëzimit të tij.

2. Në rastet kur është e pamundur që pasuria kulturore e rikuperuar të ruhet, duke respektuar kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, Policia e Shtetit, zyrat doganore ose agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, që mbajnë përkohësisht pasurinë në fjalë, në bashkëpunim me IKRTK-në dhe ose institucionet e tjera të specializuara të trashëgimisë kulturore, duhet të identifikojnë një mjedis të përshtatshëm për ruajtjen e saj, siç janë muzetë, bibliotekat, institucionet e tjera të specializuara të trashëgimisë kulturore, ku pasuria kulturore të transportohet, me kujdesin e nevojshëm dhe duke respektuar teknikat e specializuara të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me qëllim parandalimin e dëmtimit të pasurisë kulturore.

XV. KTHIMI I PASURISË KULTURORE

1. Pasi autoriteti gjyqësor ka marrë vendimin e kthimit të pasurisë kulturore tek pronari i ligjshëm apo përfaqësuesit e tij dhe, pasi nga ana e pronarit të ligjshëm apo përfaqësuesit është njohur zyrtarisht pronësia e pasurisë kulturore, objekt i shqyrtimit gjyqësor, operatori kryen veprimet e mëposhtme:

a) harton raportin përkatës;

b) përditëson regjistrin e pasurive kulturore që ndodhen nën kujdes, në përputhje me detyrimet e

përcaktuara sipas pikës 1, shkronja "d", të kreut XIV të këtij udhëzimi;

c) informon IKRTK-në për kthimin e pasurisë kulturore, e cila duhet të miratojë të gjitha ndryshimet në bazën e të dhënave.

XVI. DISPOZITAT E FUNDIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, IKRTK-në dhe drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

URDHËR
Nr. 156, datë 15.11.2023

PËR PËRCAKTIMIN E DREJTORISË QË DUHET TË PËRMBUSHË ROLIN E AUTORITETIT MENAXHUES E TË DREJTUESIT TË AUTORITETIT MENAXHUES, SI DHE DELEGIMI I TË DREJTAVE TË NËNSHKRIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të aneksit B, nënseksioni 3, të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, të nenit 28, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në përputhje me nenin 8, pika 8, dhe nenin 12, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023, "Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)",

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Industrisë dhe Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, caktohet për të përmbushur përgjegjësitë e Autoritetit Menaxhues të Programit Operativ Shumëvjeçar për energjinë (2024–2027) në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023, "Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)" (vendimi IPA III" dhe Marrëveshjen Financiare Kuadër të Partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022 ("Marrëveshja Kuadër");

2. Z. Ardian Islami, si drejtues i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Industrisë dhe Energjisë është drejtuesi i Autoritetit Menaxhues, në përputhje me nenin 8, pika 8, të vendimit IPA III.

3. Z. Ardian Islami, si drejtues i Autoritetit Menaxhues, është i autorizuar të nënshkruajë dokumentet e mëposhtme:

- Marrëveshje mbi bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Koordinatorit Kombëtar të IPA-s, Zyrtarit Kombëtar të Autorizimit, Organeve të Ndërmjetme për Menaxhimin e Politikave dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar për zbatimin nën menaxhimin indirekt të programit operativ shumëvjeçar për energjinë (2024–2027) në Republikën e Shqipërisë;
- Marrëveshjet me marrësit fundorë të ndihmës IPA III;
- Manualet e procedurave IPA III të zbatueshme për autoritetin menaxhues;
- Çdo raport, dokument apo komunikim tjetër lidhur me IPA III drejtuar koordinatorit kombëtar të ISPA-s, zyrtarit kombëtar autorizues, autoritetit auditues, organit kontabël, Zyrës Mbështetëse të ZKA-së, organeve të ndërmjetme për menaxhimin e politikave, Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar, AFCOS, Delegacionit Evropian, Shërbimeve të Komisionit Evropian,

programeve të tjera që menaxhojnë autoritetet ose organet e ndërmjetme.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 642, datë 13.11.2023

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, GJIMNAZI "UNIVERSI" BALLSH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të pikës 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga",

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Universi" Ballsh, të subjektit juridik Glavenica, sh.p.k., me NIPT: K17710805A, të cilit i është dhënë leja e funksionimit me urdhrin nr. 194, datë 17.07.2002, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar", me kërkesën e tij nr. 23110 prot., datë 23.10.2023.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Universi" Ballsh, ka për detyrë:

a) Të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Mallakastër, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

b) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Mallakastër, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

c) Të kthejë pagesat e kryera nga prindi/ përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur, nëse ka.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Mallakastër, ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Universi" Ballsh.

b) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat.

c) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Universi" Ballsh.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Mallakastër, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve, nga institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Universi" Ballsh, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Mallakastër, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 194, datë 17.7.2002, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar", shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Mallakastër, institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi "Universi" Ballsh.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
ARSIMIT DHE SPORTIT
Nina Guga

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 11485/11

FEDERATA SHQIPTARE E MUNDJES DHE VIRON BEZHANI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 19 shtator 2023, si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides*, President*,
Darian Pavli,
Oddný Mjöll Arnardóttir*, gjyqtarë*,
dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*
Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 11485/11) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") më 16 shkurt 2011 nga Federata Shqiptare e Mundjes (*shoqata "Federata Shqiptare e Mundjes"* – "federata" ose "kërkuesi i parë") regjistruar pranë gjykatës kompetente në vitin 2009 dhe me seli në Tiranë dhe z. Viron Bezhani, i lindur në vitin 1958, banues në Tiranë ("kërkuesi i dytë" ose bashkërisht "kërkuesit"). Ata përfaqësohen nga z. A. Hajdari, avokat me licencë në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar fillimisht nga Agjentja znj. A.Hiçka, dhe më pas nga Agjenti z. O.Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për mosekzekutimin nga autoritetet e brendshme të një vendimi arbitrar që kishte shpallur të pavlefshëm zgjedhjet e mbajtura nga federata.

A. Konteksti

2. Kërkuesi i parë është një shoqatë qëllimet e të cilës përfshijnë, mes të tjerave, bashkimin në një federatë të të gjitha klubeve dhe shoqatave shqiptare në fushën e mundjes, organizimit të konkurseve kombëtare të mundjes dhe përfaqësimit të komunitetit të mundjes brenda dhe jashtë vendit. Duket se për të përmbushur këto qëllime, kërkuesi i parë gëzon të drejtën ekskluzive që i është dhënë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ("Ministria").

3. Në periudhën në fjalë, kërkuesi i dytë ishte sekretari i përgjithshëm i Federatës.

B. Vendimi i Komisionit të Arbitrazhit Sportiv

4. Më 1 mars 2009, disa anëtarë të federatës zhvilluan një mbledhje të jashtëzakonshme ku A.Z dhe A.H u zgjodhën President dhe Sekretar i Përgjithshëm i federatës përkatësisht ("zgjedhjet e kontestuara").

5. Më 3 mars 2009, ministri miratoi A.H si sekretar të përgjithshëm të federatës. Vendimi i tij, i dhënë në formën e një urdhri, u bazua në nenin 14, pika 2, të Ligjit për Sportin (ligji nr. 9376, i ndryshuar) ku parashikohej se çdo ndryshim i synuar i statutit të "federatave" (d.m.th shoqatave siç është kërkuesi i parë, të cilit i është dhënë e drejta ekskluzive për të bashkuar në federatë shoqata dhe klube të tjera në një sport të caktuar) do t'i paraqitet për miratim ministrisë.

6. Më 11 mars 2009, A.B, kërkuesi dhe kërkuesi i dytë, në cilësitë e tyre pretenduara, përkatësisht president dhe sekretar i përgjithshëm i federatës, kundërshtuan ligjshmërinë e zgjedhjeve të kontestueshme përpara Komisionit të Arbitrazhit Sportiv ("KAS") i cili është forumi i brendshëm i arbitrazhit në fushën e sportit.

7. Më 2 prill 2009, KAS-i pranoi padinë dhe shpalli të pavlefshme zgjedhjet e mbajtura më 1 mars 2009 ("vendimi i KAS-it"). Në vendim nuk tregohej se kush ishte i padituri në proces. Tribunali i arbitrazhit i referohej kërkuesit të dytë si sekretar i përgjithshëm i federatës dhe konstatoi që mbledhja e jashtëzakonshme e datës 1 mars 2009 ishte thirrur dhe organizuar nga persona të paautorizuar.

8. Më 9 prill 2009, kërkuesi i dytë i dërgoi ministrisë vendimin e KAS-it.

9. Më 17 korrik 2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nxori një *urdhër ekzekutimi* që parashikonte zbatimin e vendimit të KAS-it. Më 31 korrik 2009, Zyra Përmbarimore Tiranë filloi procedurën e ekzekutimit dhe i kërkoi ministrisë që të zbatonte vendimin e KAS-it.

10. Më 2 shtator dhe 24 nëntor 2009 përmbaruesi i kërkoi përsëri ministrisë që të zbatonte vendimin e KAS-it dhe të shpallte pavlefshmërinë e zgjedhjeve të 1 marsit 2009.

11. Më 2 dhjetor 2009, ministria informoi përmbaruesin që sipas ministrisë i padituri në proces ishte federata, jo ministria, prandaj ajo nuk ishte e detyruar që të merrte masa në lidhje me vendimin e KAS-it.

12. Në korrespondencën në vijim, të 8 dhjetorit 2009, drejtuar përmbaruesit, ministria u shpreh që federata ishte një subjekt i pavarur privat, prandaj ministria nuk mund të ndërhynte me zbatimin e vendimit të KAS-it i cili, sipas saj, duhej të ishte zbatuar nga organet drejtuese të federatës.

C. Proceset gjyqësore

13. Më 30 tetor 2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vëren që kërkuesi i dytë nuk ishte paraqitur në seancën dëgjimore, në lidhje me kundërshtimin e tij ndaj urdhrit të ministrisë për të miratuar A.H si sekretar të përgjithshëm të federatës (shihni paragrafin 93më sipër). Në këto rrethana e pushoi procesin.

D. Ngjarjet e mëpasshme

14. Më 30 janar 2010 u mbajt një tjetër mbledhje e përgjithshme e federatës dhe zgjodhi kërkuesin e dytë si president të federatës.

15. Më 17 maj 2010, në një korrespondencë me Bashkinë e Laçit, ministria u shpreh që: "njeh, financon dhe i jep të drejtën të përfaqësojë Shqipërinë në konkurse brenda dhe jashtë vendit [federatës] me president [A.Z.] dhe sekretar të përgjithshëm [A.H].".

16. Në korrespondencën e 14 qershorit 2010, kërkuesi i dytë u ankua përpara ministrisë që ata nuk e kishin miratuar atë akoma si president të federatës.

17. Më 6 tetor 2010, ministria informoi organet e federatës që zbatimi i vendimit të KAS-it të 2 prillit 2009 ishte detyrim ligjor.

18. Në një korrespondencë tjetër të 3 dhjetorit 2010, ministria informoi federatën që ministria do të mbështeste çdo vendim të marrë nga "komuniteti i mundjes", në lidhje me përfaqësimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 6, paragrafi 1 i Konventës

19. Kërkuesit u ankuan sipas nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, që organet e ligjshme të federatës nuk njiheshin akoma në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe që vendimi i KAS-it i 2 prillit 2009 nuk ishte zbatuar *de facto*.

20. Gjykata vëren që, nisur nga mosmarrëveshjet e brendshme, mund të jetë e hapur për diskutim nëse kërkuesi i dytë mund të përfaqësojë federatën dhe të depozitojë në emër të saj këtë kërkesë, ashtu siç ai bëri. Megjithatë, kjo pyetje mund të lihet e hapur sepse ankimimi gjithsesi është haptazi i pabazuar.

21. Përpara gjykatave të brendshme ose tribunaleve të arbitrazhit u shtruan pyetjet nëse zgjedhjet e 30 janarit 2010 të mbajtura nga federata ishin të ligjshme dhe nëse autoritetet shtetërore kishin dështuar me njohjen e rezultatit të tyre, dhe prandaj ato janë të papranueshme përpara Gjykatës. Prandaj qëllimi i çështjes përpara Gjykatës është i kufizuar me faktin nëse ndonjë veprim ose mosveprim i autoriteteve shtetërore ka çuar në moszbatimin e vendimit të KAS-it, të 2 prillit 2009, (shihni parimet e përgjithshme në çështjen *Sekul kundër Kroacisë* (dhjetor), nr. 43569/13, paragrafi 54, 30 qershor 2015).

22. Deklarata e ministrisë në shkresën e 17 majit 2010 (shihni paragrafin 103 më sipër) që A.Z. dhe A.H ishin zyrtarë të ligjshëm të federatës duket se anashkalon vendimin e KAS-it, i cili e kishte shpallur të pavlefshme zgjedhjen e tyre në detyrë. Parashtrimi i Qeverisë përpara Gjykatës nuk dha ndonjë shpjegim në këtë drejtim.

23. Megjithatë, edhe pse kjo korrespondencë është arsye për t'u shqetësuar, në mungesë të veprimeve ose mosveprimeve të tjera të autoriteteve shtetërore, në vetvete është e pamjaftueshme për të mbështetur përfundimin se autoritetet e brendshme kanë dështuar me zbatimin e vendimit të KAS-it.

24. Edhe pse me pak vonesë pas korrespondencës së mësipërme, autoritetet e brendshme në fund miratuan një qëndrim të qartë që vendimi i KAS-it ishte i detyrueshëm dhe që duhej të zbatohej nga organet e federatës (shihni paragrafin 105 më sipër).

25. Gjithashtu është e rëndësishme që vendimi i KAS-it ishte thellësisht deklarues dhe nuk orientonte ndonjë autoritet shtetëror që të kryente ndonjë veprim specifik. As kërkuesit nuk identifikuan ndonjë veprim që autoritetet shtetërore në mënyrë të nënkuptuar duhej të ndërmerrnin dhe nuk e ndërmorën për shkak të vendimit të KAS-it.

26. Për rrjedhojë, ankimimi në lidhje me moszbatimin e vendimit të Komisionit të Arbitrazhit Sportiv, të 2 prillit 2009, është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35, paragrafi 3(a) dhe 4, të Konventës.

B. Ankimime të tjera

27. Ankimimi i kërkuesit që moszbatimi i vendimit të KAS-it përbënte shkelje të nenit 11 të Konventës, gjithashtu, është haptazi i pabazuar për të njëjtat arsye si ato të parashtruara në paragrafët e mësipërm.

28. Kërkuesi i dytë u ankua që ai nuk e kishte marrë pagën e tij mujore si president i federatës dhe prandaj ishte shkelur neni 1, i Protokollit nr. 1 të Konventës. Megjithatë, detyrimi i federatës për të paguar kërkuesin nuk ishte pjesë e çështjeve të zgjidhura nga vendimi i KAS-it. As kërkuesi i dytë nuk filloi procesin e brendshëm për të kërkuar që t'i jepeshin pagat e tij. Për rrjedhojë, ky ankim është i papranueshëm për mosshterim të mjeteve të brendshme ligjore, në përputhje me nenin 35 § § 1 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 tetor 2023.

Olga Chernishova	**Georgios A. Serghides**
ZËVENDËSKANCELARE	PRESIDENT

KËRKESË

Shtetasja Mimoza Arapi kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Petrit Çela, i lindur më 2.5.1935 në Krujë dhe banues në Tiranë, me atësi Zejnel dhe amësi Sulltane.

KËRKUESE
Mimoza Arapi

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 169
Datë: 2023/11/20 16:21:06
b9c0c2c9-afd5-459c-b48f-c0ef58c13902

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë